

Përkujdesi nga familjarët dhe sëmundja e demensit

FLETUSHKA FAKTIKE NGA QENDRA SUEDEZE PËR DEMENS

Anhörigvård och demens • faktablad på albanska

Përkujdesi nga familjarët është shumë i çmueshëm

Përafërsisht 160 000 persona vuajnë nga ndonjë sëmundje e demensit. Numri i të prekurve nga kjo sëmundje rritet në përpjestim me rritjen e vjetërsisë së popullsisë. Shumë profesione të ndryshme janë të implikuara në përkujdesjen e këtyre personave, por e gjithë kjo do të ishte shumë më e vështirë pa ndihmën e familjarëve dhe të afërmeve.

Harmonia e përditshme

Sëmundjet e demensit shkaktojnë probleme me kujtesën, të folurit, ndjenjat dhe një radhë aftësish të tjera vetjake. Me një përkrahje të përshtatshme, i sëmunduri mundet që në mënyrë të kënaqëshme ta përballojë përditshmërinë në fazat fillestare të sëmundjes. Familjarët dhe të afërmit e personave me demens mund tu ua lehtësojnë përditshmërinë, në atë mënyrë që gjithmonë të mundohen të jenë "një hap para".

Ekzistojnë gjithashtu mjete ndihmëse të cilat, pjesërisht i kompensojnë vështirësitë e shkaktuara nga sëmundja e demensit

Zakonisht ndjehen të pamjaftueshëm

Situata tek të afërmit vështirësohet si fizikisht ashtu dhe psikikisht. Përditshmëria është sa kuptimplote aq dhe me shumë ngarkesë. Shumë të afërm ndjehen të shqetësuar, të pamjaftueshëm dhe ndjehen si me faj. Ata shpesh vuajnë nga pagjumësia. Shoqërimi me miq dhe familjarë bëhet më i vështirë.

Mos harroni shëndetin tuaj

Studimet vërtetojnë se shëndeti i të afërmeve gjendet shpesh në zonën e rrezikut. Për këtë edhe është e rëndësishme të përkujdeseni për shëndetin tuaj, e jo vetëm për shëndetin e të sëmurit me demens.

Ju si familjar ose i afërm mund të kërkonit ndihmë dhe është me rëndësi të dini kujt ti drejtoheni.

Eksitojnë mënyra të ndryshme për përkrahje

Komuna ku jetoni, sipas Ligjit për shërbimin social, detyrohet tu sigurojë mbështetje personave që përkujdesen për të sëmurit me sëmundje të demensit. Ndiham

në shtëpi si dhe mënyra të tjera që ofrohen për të sëmurët, paraqesin lehtësim për të afërmit.

Ndiham varion prej komune në komunë. Këtu do të cekim disa shembuj që janë të zakonshëm:

- Aktiviteti ditor
- Ndiham në shtëpi dhe zëvendësimi i familjarëve në shtëpi
- Këshilla dhe edukim
- Banim të perkohshëm
- Bisedë në grup
- Ndihamesa teknike
- Takime për të afërmit e të sëmurëve me sëmundjen e demensit.



Për informata më të detajuara se çfarë ndihme mund të merrni në komunën tuaj i drejtoheni referentit për mbështetje në komunë, infermieres rajonale ose këshilltarit për të afërmit.

Nuk jeni vetëm

Një numër i madh i të afërmeve të personave me sëmundjen e demensit i drejtohen gjithashtu Aleancës për demens (Demensförbundet), Shoqatës për Alzheimer (Alzheimers föreningen) dhe Shoqatës e të afërmeve (Anhörigas Riksförbundet).

Përmes shoqatave lokale mund të merrni këshilla dhe këmbeni provoja me persona në të njëjtat situata. Gjithashtu organizohen ligjërata, seminare dhe ekskurSIONE.

Demensförbundet/Aleanca për demens,

Tel: 08-658 99 20, Webfaqja: www.demensförbundet.se

Alzheimersföreningen/Shoqata për Alzheimer,

Tel 046-14 73 18, Webfaqja www.alzemerforeningen.se

Anhörigas Riksförbundet/Shoqata kombëtare e të afërmeve, Tel: 0474-40 400

Webfaqja: www.ahrisverige.se

30 janar 2016 • Svenskt Demenscentrum®

Më shumë informata në gjuhët e ndryshme mund ti lexoni në portalin Qendra Suedeze për demens:
www.demenscentrum.se/Faktablad



Svenskt Demenscentrum

Svenskt Demenscentrum, Gävlegatan 16, 113 30 Stockholm, 08 - 690 58 00, info@demenscentrum.se

www.demenscentrum.se